


GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS SË GJAKOVËS

Janar 2025



INFORMATË

PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN-2024

Të nderuara anëtare dhe të nderuar anëtar të Kuvendit,

Ky dokument ofron informata për publikun për punën e Kuvendit, për mbledhjet dhe aktivitetet e zhvilluara përgjatë vitit kalendarik 2024. Kjo mënyrë e informimit, për të tretin vit me radhë e filluar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, i shërben anëtarëve të kuvendit dhe publikut të gjerë për t'i mbajtur ata të informuar dhe për të siguruar transparencën e duhur në lidhje me zhvillimet dhe proceset vendim-marrëse.

Në përputhje me planin e punës, Kuvendi i Komunës së Gjakovës e ka përmbytur planin e saj për vitin 2024 dhe ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta.¹

Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur dy mbledhje solemne, njëra mbledhje solemne për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës me 17 Shkurt, dhe tjetra mbledhje solemne për nder të 25 vjetorit - Dita e Çlirimit të Gjakovës me 14 Qershor. Në këtë vit është mbajtur një mbledhje e jashtëzakonshme dhe një mbledhje e përbashkët me karakter ndërkombëtar me Këshillin Bashkiak të Sarandës në Bashkinë e Sarandës.

Gjatë vitit 2024 Kuvendi i Komunës së Gjakovës i ka shqyrtuar gjithsej: 110 pika të rendit të ditës nga gjithsej 50 pika sa kanë qenë të planifikuara në planin e Punës së Kuvendit për vitin 2024. Ka miratuar 48 akte nga të cilat 47 vendime dhe 1 rregullore.

Bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës, të gjitha njoftimet e ftesat për takimet e Kuvendit, të Komitetit për Politikë e Financa, të komiteteve tjera dhe aktivitetet me rëndësi (rendi i ditës dhe materialet) janë publikuar me kohë në faqen zyrtare të Komunës, rrjetet sociale dhe media lokale. Më pas, edhe aktet e Kuvendit janë publikuar me kohë.

Që nga hyrja në fuqi e rregullores së punës (2022), ftesat dhe materiali përcjellës për takimet e kuvendit dërgohen përmes postës elektronike në adresat e anëtarëve të kuvendit. Kjo mënyrë ka ngritur nivelin e komunikimit efektiv dhe ka ulur dukshëm shpenzimet e shërbimit postar dhe letrës (A4). Sipas numërorit në shtypës (printer), për periudhën nëntor 2021 - 2022 janë 49.767 fletë të shtypura; nëntor 2022 – 2023 janë 24.220 fletë (rreth 50 për qind më pak), ndërsa nëntor 2023 – 2024 janë 33.313 fletë gjithsej.

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë të hapura për publik dhe ato janë transmetuar drejt për së drejti nga mediat lokale, e gazetarët janë shërbyer me informata shtesë dhe materiale të nevojshme.

Puna e kuvendit në takimet e rregullta karakterizohet me marrjen e vendimeve të rëndësishme, përfshirë edhe miratimi i Hartës Zonale Komunale 2024-2032 të Komunës së Gjakovës.

¹ Ligjin për Vetëqeverisje Lokale parasheh mbajtjen e së paku dhjetë (10) mbledhje brenda vitit.

Në vitin 2024 nga MAPL-ja janë kthyer vetëm dy akte për rishqyrtim! Kuvendi ka marrë hapat e domosdoshme për veprim dhe ka përmbushur kërkesat sipas rekomandimeve nga niveli qendror dhe këto akte janë rishqyrtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përputhje me nenin 52 të LVL-së, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur **11** takime të rregullta dhe ka shqyrtuar çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë **10** mbledhje të rregullta.

Në vitin 2024, Kuvendi i Komunës së Gjakovës e ka tejkaluar planin e punës duke e përmbushur dhe tejkaluar me diskutimin e pikave të rendit të ditës që nuk kanë qenë të planifikuara në plan të punës. Të gjitha çështjet që kanë qenë të planifikuara në plan të punës janë shqyrtuar në Kuvend, por ka pasur pika të tjera që për çështje teknike janë trajtuar në mbledhjet tjera.

Komitetet Konsultative:

1. Komiteti për Arsim ka mbajtur 1 mbledhje.
2. Komiteti për Shëndetësi nuk ka mbajtur mbledhje për këtë vit.
3. Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur 1 mbledhje, ndërsa nga muaji korrik 2024 ka përfunduar mandati i këtij komiteti dhe nuk është më aktiv.

Komitetet tjera të kuvendit:

1. Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur 3 mbledhje.
2. Komiteti për Barazi Gjinore, nuk ka mbajtur mbledhje për vitin 2024
3. Komiteti për Kulturë, Rini, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor nuk ka mbajtur asnjë mbledhje.

Sipas kryesuesve të këtyre komisioneve, me hyrjen në fuqi të Ligjit të Pagave për Zyrtarët Publik, anëtarët e këtyre organeve nuk janë paguar dhe si pasojë nuk janë mbajtur mbledhjet për shkak të mungesës së kuorumit.

Nga fillimi i vitit 2024, Kryesuesja e Kuvendit bashkë me Sekretarin e Kuvendit, Menaxherin e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Financave kanë mbajtur disa takime për të gjetur një zgjidhje ligjore për kompensimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete ku pas shumë përpjekjeve është lidhur marrëveshja në mes të Kryetarit të Komunës dhe anëtarëve të këtij komiteti, dhe sipas marrëveshjes kompensimi do të bëhet nga linja e shërbimeve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Në përputhje me obligimet ligjore për projekt buxhetin komunal për vitin 2025, Kryesuesja me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, e në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Buxhet dhe Financa ka organizuar dy (2) dëgjime buxhetore me publikun dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Sfidat e punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës

Puna e Kuvendit të Komunës ka pasur pengesa të cilat kanë sfiduar mbarëvajtjen e saj. Gjatë këtij viti anëtarët e Kuvendit në të përgjithshmen kanë munguar 66 herë, nga këto, 34 mungesa pa arsye dhe 32 me arsye.

Sfidë tjetër ishte mos-respektimi i rregullores së punës së Kuvendit, posaçërisht në rastet kur disa nga anëtarët e kuvendit flasin nga vendi pa lejen e Kryesueses, ose duke ndërhyrë në fjalimet e atyre që ishin duke folur. Mos qëndrimi në sallë i anëtarëve të Kuvendit gjatë punimeve të Kuvendit, por edhe vonesat, largimi i tërësishëm dhe mungesat pa-arsye janë vërejtur shpeshherë të cilat kanë shkaktuar edhe ndërprerjen e mbledhjeve për shkak të mungesës së Kuorumit.

Aktivitetet e Kryesueses së Kuvendit të Komunës

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, në përputhje me Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale (LVL), neni 47.1, është konsultuar rregullisht me Kryetarin e Komunës gjatë përpilimit të pikave të rendit të ditës për mbledhjet e kuvendit, por edhe për çështjet tjera të rëndësishme të veçantë. Gjithashtu, Kryesuesja ka marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete.

Përgjatë këtij viti, në zyrën e Kryesueses së Kuvendit janë dorëzuar **223** kërkesa nga qytetarët dhe përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile, ndërsa janë trajtuar **204** prej tyre, **6** janë refuzuar dhe **10** janë në proces. Njëra nga kërkesat (e dorëzuar me datën 22/02/2024) është Peticioni për ndryshimin e mënyrës së ndarjes së subvencioneve në fushën e Rinisë dhe Sportit për Komunën e Gjakovës e nënshkruar nga 32 OJQ dhe Klube Sportive të Komunës së Gjakovës. Në përputhje me legjislacionin në fuqi e në bashkëveprim me drejtoritë përkatëse, kjo kërkesë është shqyrtuar dhe janë ndërmarr hapat për ndryshimet e nevojshme në përkrahje të kërkesës.

Kryesuesja e Kuvendit në cilësinë e kryesueses së komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave për rrimërtimin e rrugëve ka mbajtur disa takime dhe i ka propozuar Kuvendit në mbledhjen e Janarit (30/01/2024) të vitit 2024 listën me 10 emra për plotësim-ndryshimin e listës rezervë për emërtimet e Zonave të Qarkullimit Publik. Pjesë e kësaj liste ka qenë edhe emërtimi i Parkut “Xhubleta”, dhe është hartuar projekti i cili është planifikuar në buxhetin e Komunës dhe në Planin e Punës së Prokurimit për realizim në vitin 2025.

Në kuadër të hartimit të buxhetit fiskal për vitin 2025, Kryesuesja e Kuvendit ka kërkuar nga drejtoria për buxhet dhe financave (nga drejtori z. Durim Halilaj) që “Parku Xhubleta” të futet me kod të veçantë në buxhetin e vitit 2025, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në mbledhjen e muajit Shtator, ku edhe është miratuar buxheti i komunës për vitin 2025, ky projekt është vendosur në buxhet si një ndër investimet kapitale më domethënëse në komunën tonë, që është dedikim për të gjitha vajzat dhe gratë që kanë kontribuar në të gjitha periudhat historike dhe në të gjitha sferat e jetës për Komunën e Gjakovës.

Kryesuesja e Kuvendit ka përfaqësuar komunën e Gjakovës me pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Në fushën e rrjetëzimit, Kryesuesja ka bashkëpunuar dhe ka ndarë përvojat e Kuvendit me komunat e tjera të Kosovës dhe rajonit. Ajo ka ofruar prezantime që promovojnë transparencën, llogaridhënien dhe mënyrat e bashkëpunimit në kuvend. Po ashtu, është angazhuar në diskutime mbi politikën e barazisë gjinore, duke përfshirë temat e përfaqësimit të gruas në politikë, emancipimin e gruas dhe vajzave, dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara. Ky angazhim është një shembull i përkushtimit të Kryesueses për të promovuar vlera të barazisë dhe përfshirjes në politikë. Ndër të tjera, Kryesuesja ka zhvilluar takime zyrtare, me qytetarë, me homologët e komunave tjera, takime me organizata ndërkombëtare, përfshirë NDI (anëtarësimi në OGP), Fondacioni 'Jahjaga', OSBE, USAID, UN WOMEN, UBSHR dhe me përfaqësues nga ambasadat e shteteve të huaja në Republikën e Kosovës.

Me ftesë nga Aleanca Kombëtare e Këshilltarëve Bashkiake të Shqipërisë Kryesuesja e Kuvendit morri pjesë si paneliste në Konferencën Rajonale “Gruaja në pushtetin vendor, imazhi dhe fuqizimi i rolit të saj” e cila është mbajtur në Vlorë me datë 27 dhe 28 Shtator të vitit 2024.

Me ftesën e Forumit Global të Grave të mbajtur në Reykjavik (Islandë) Kryesuesja morri pjesë në këtë tribunë të rëndësishme që kishte për qëllim trajtimin e sfidave të gruas në politikë dhe ekonomi, por edhe shkëmbimin e përvojave me shtetet e zhvilluara.

Në kuadër të bashkëpunimit me komunat ndërkufitare të Republikës së Shqipërisë, Kryesuesja bashkë me Kryetarin e Komunës me ftesën e Kryetarit të Bashkisë së Bajram Currit, kanë realizuar një takim të përbashkët në kuadër të bashkëpunimit me komunat ndërkufitare. Ndërsa me ftesën e Kryetarit të Bashkisë së Hasit kanë vizituar Bashkinë e Hasit dhe kanë trajtuar mundësitë e bashkëpunimit për t'u zbatuar në vitin 2025.

Në nismën e vendosur nga Kryesuesja me komunitetin Arbëresh, fillimisht në fillim të vitit 2023 janë mirëpritur tre Kryetarët e Komunave të komunitetit Arbëresh në Itali në Komunën e Gjakovës, dhe anasjelltas me ftesë nga kryetari i komunës së Frascineto z. Angelo Catapano në prill të vitit 2024, Kryesuesja e Kuvendit dhe Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini me bashkëpunëtor kanë qenë të ftuar për të vizituar komunat Frascineto, Civita dhe Firmoza. Këto takime me komunitetin arbëresh shënojnë fillimin e një bashkëpunimi të ngushtë në të gjitha sferat e jetës, me theks të veçantë në rrafshin kombëtar dhe shpirtëror të të dy komuniteteve. Ato gjithashtu shërbejnë për të ngritur mundësitë e bashkëpunimit në fusha të tjera, duke forcuar lidhjet dhe duke promovuar një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të dobishme.

Në kuadër të takimeve me komunat e binjakëzuara, Kryesuesja ka bashkë-vepruar me homologun e saj në Sarandë dhe kanë organizuar mbledhjen e parë formale në mes të dy kuvendeve. Në mbledhjen e përbashkët me Këshillin Bashkiak të Sarandës me 25 Nëntor 2024 është diskutuar mundësia e bashkëpunimit dhe jetësimit të marrëveshjes për bashkëpunim në mes të dy komunave tona. Në këtë takim pjesëmarrës ishin edhe anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Për të njëjtin qëllim, në fillim të vitit, Kryesuesja dhe Kryetari i Komunës pritën në takim delegacionin nga Komuna e Tuzit me qëllim të diskutimit dhe krijimit të mundësive konkrete të bashkëpunimit në mes të dy komunave. Më pas, me ftesë nga Kryetari i Kuvendit të Komunës së Tuzit z. Fadil Kajoshaj, Kryesuesja dhe Kryetari i Komunës vizituan këtë komunë për të shënuar “Ditën e Gjakovës” të cilën e kanë organizuar komuna e Tuzit. Me ftesën e Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon (UBSHR), Kryesuesja e Kuvendit morri pjesë në aktivitetet e datës 27 dhe 28 nëntor në Tirane, me rastin e ditës së Pavarësisë së Shqipërisë.

Mbështetja e ofruar nga zyra e Kryesueses për vitin 2024

Kryesuesja e Kuvendit ka zhvilluar takime e ka pasur diskutime për çështje të ndryshme profesionale me qytetarë dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme për trajtimin e mundësive për mbështetje dhe përkrahje. Në këtë aspekt, është ofruar vullnet institucional që brenda mandatit dhe kompetencave ligjore të bashkëpunohet dhe bashkëveprohet në funksion të demokracisë. Zyra e Kryesueses ka mbështetur këto nisma dhe kërkesa:

- Grupin e grave pensioniste të Komunës së Gjakovës për nder të 8 Marsit.
- Tribunën Kombëtare “Sakrifica për liri, vlerë universale, gruaja pjesë e saj” e organizuar nga gratë ish të burgosurat politike.
- OJQ Krimet e Luftës për realizimin e dokumentarit “Fëmijët pa Liri”.
- Në kuadër të muajit Rozë ka mbështetur OJQ “Ia vlen të jetosh”.
- Korin e Grave dhe Vajzave të Komunës së Gjakovës.
- Për vitin e tretë me radhë, në bashkëpunim me organizatën e të rinjve YMCA si dhe me Asamblenë e Fëmijëve e ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Vajzave (11 Tetor).

Arbëneshja Kuqi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

